

VENDIM
Nr.551, datë 29.12.1992

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË
TREGTISË E TË BASHKËPUNITIT EKONOMIK ME JASHTË DHE PROJEKTIT
NDËRKOMBËTAR BAMIRËS ISLAMIK (ICPI)**

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit me Jashtë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit me Jashtë dhe Projektit Ndërkombëtar Bamirës Islamik (ICPI) me vërejtjen që pika 7 të formulohet si vijon:

"Materialet dhe pajisjet që do të sillen si ndihmë falas nga ICPI, si pajisjet mjekësore, ushqimet, materialet e ndërtimit, librat etj., të cillat kanë lidhje me veprimtari jofitimprurëse, janë të përjashtuara nga taksat doganore. Kjo do të zbatohet edhe për përfaqësuesit e nëpunësit në lidhje me pagat e pajisjet e tyre të importuara, që do të përdoren për nevoja personale. Gjithashtu qeveria do të pajisë me vizat e nevojshme ekipin e ICPI që dëshiron të hyjë në Shqipëri".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi